



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_. \_\_. 2020

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8378/1998, “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “F”, shtohet shkronja “G” me titull “Rrugë shkollë”.
2. Në pikën 3, pas shkronjës “F”, shtohet shkronja “G” me këtë përmbajtje:

“G. Rrugë shkollë: Zonë urbane, ose interurbane në të cilën janë në fuqi rregulla të posaçme qarkullimi në mbrojtje të këmbësorëve dhe në veçanti të nxënësve të shkollave, e kufizuar nga sinjale të posaçme fillimi dhe fundi”.

**Neni 2**

Në nenin 7, pika 12 ndryshohet si më poshtë:

**“12. Kushdo që nuk respekton ndalimin e qarkullimit, qarkullon në sens të kundërt me atë të lejuar, nuk zbaton detyrimin e përparësisë dhe të ndalimit në kryqëzim, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë, deri në dhjetë mijë lekë dhe për rastet kur qarkullon në sens të kundërt me atë të lejuar, përveç masës së mësipërme, drejtuesit të mjetit i pezullohet leja e drejtimit për një periudhë 3-**

**mujore dhe hiqen gjithashtu 5 pikë nga leja e drejtimit”.**

### **Neni 3**

Në nenin 36, në pikën 3 dhe 7, togfjalëshi “Autoriteti Rrugor Kombëtar”, zëvendësohet me “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve”.

### **Neni 4**

Në pikën 1 të nenit 38, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) sinjalet me mesazhe sociale dhe ndërgjegjësimi”.

### **Neni 5**

Në nenin 41, pas pikës 18 shtohet pika 19 me këtë përmbajtje:

“19. Në të gjitha rastet e impianteve semaforikë, drita e verdhë paralajmëruese nuk duhet të jetë më e shkurtër se 5 sekonda”.

### **Neni 6**

Në nenin 71, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

**“6. Kushdo që qarkullon me një mjet të blinduar, për të cilin mungon autorizimi i lëshuar nga organi kompetent, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga njëqind mijë deri në dyqind mijë lekë dhe zbatohet masa administrative plotësuese e konfiskimit administrativ të mjetit. Të njëjtat masa zbatohen ndaj zotëruesit të mjetit nëse ky i beson mjetin një drejtuesi të paautorizuar”.**

### **Neni 7**

Në nenin 92, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas togfjalëshit “leje qarkullimi”, shtohet togfjalëshi “sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me përmbajtje:

“6/1. Qendra e Informacionit, e krijuar sipas ligjit, njofton menjëherë organet e ngarkuara nga ligji për regjistrimin e mjeteve dhe ato të kontrollit të qarkullimit rrugor, mbi mjetet e pasiguruara për ekzekutimin e masave administrative të parashikuara në këtë nen dhe sigurimin e mjeteve pas marrjes së këtyre masave”.

### **Neni 8**

Në nenin 117/1, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zotëruesit e lejedrejtimeve vendase të grupit “A1 dhe A2”, nuk mund të drejtojnë motomjete me fuqi më të madhe se 25kw specifike referuar ngarkesës ose me fuqi më të madhe se 0,16 kw/kg”, për tre vitet e para pas marrjes së lejedrejtimit.”

2. Pika 4 shfuqizohet.

## Neni 9

Në nenin 120/1, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

**“1. Mbajtësi i lejedrejtimit ka në dispozicion një sasi prej njëzetë pikësh. Kjo sasi pikësh, shënohet në regjistrin kombëtar të personave të aftësuar për drejtimin e mjeteve, të parashikuar në nenet 220 dhe 221 të këtij Kodi, më poshtë “Regjistri kombëtar”. Pikët hiqen si pasojë e shkeljeve të normave të sjelljes në rrugë, për të cilat është parashikuar një masë administrative plotësuese e pezullimit të lejedrejtimit, ose kur është e parashikuar në mënyrë specifike në dispozitat e kapitullit V të këtij Kodi. Sasia e pikëve që hiqet për çdo shkelje, rezulton nga vendimi i organit epror të agjentit verifikues dhe nga njoftimi i çdo kundërvajtje për të cilën në normat e këtij Kodi është parashikuar heqje pikësh”.**

2. Në pikën 4 shtohet fjalia: “Sasia e pikëve sipas kërkesës i dërgohet ose i bëhet e ditur çdo drejtuesi mjeti, në postën elektronike të certifikuar.
3. Pika 6, riformulohet me këtë përmbajtje:

**“6. Me humbjen totale të pikëve, mbajtësi i lejedrejtimit ndjek një kurs një javor pranë autoshkollave të licencuara. Në përfundim të këtij kursi, drejtuesi i mjetit i nënshtrohet provimit të kualifikimit teknik, sipas nenit 128 të këtij Kodi dhe akteve të tjera normative në fuqi.**

4. Në pikën 7, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Sasia e pikëve për çdo shkelje përcaktohet në shtojcën përkatëse të këtij neni (kodi).

## Neni 10

Në nenin 124, në pikën 11, fjalët “deri në dyzet mijë lekë” zëvendësohen me “deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë”.

## Neni 11

Neni 127 ndryshohet si më poshtë:

### **Pezullimi i lejedrejtimit të mjetit dhe i certifikatës së aftësisë profesionale të mjetit**

1. Lejedrejtimi apo certifikata e aftësisë profesionale pezullohet për një periudhë kohe të përcaktuar, si masë plotësuese administrative e ndalimit të drejtimit të mjetit, kur mbajtësi i lejedrejtimit ka shkelur një nga normat e sjelljes të treguara ose përcaktuara në kapitullin 5, për periudhën e kohës së parashikuar nga secila normë.
2. Lejedrejtimi apo certifikata e aftësisë profesionale pezullohet për një periudhë të papërcaktuar, kur gjatë verifikimeve shëndetësore për konfirmimin e vlefshmërisë ose për revizionet e kryera sipas nenit 126, rezulton një humbje e përkohshme e aftësive fizike apo mendore të treguara në nenin 117. Në këto raste lejedrejtimi pezullohet derisa mbajtësi të marrë një certifikatë nga komisioni mjekësor përkatës, që vërteton rifitimin e aftësive fizike dhe mendore të kërkuara. Për masat e mësipërme të pezullimit të lejedrejtimit, njoftohet zyra që e lëshon lejedrejtimin e mjetit. Lejedrejtimi pezullohet në të gjitha rastet kur drejtuesi i mjetit konstatohet në kushtet e kërkuara nga ky Kod për pezullimin e dokumentit të lejedrejtimit. Në rast se drejtuesi i mjetit konstatohet duke drejtuar një mjet për të cilin kërkohet detyrimisht pajisja me Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP), pezullimi përfshin këtë të fundit dhe jo lejedrejtimin. Shërbimet e Policisë Rrugore marrin masa për evidentimin në sistemet e tyre, të pezullimit të lejedrejtimit ose të certifikatës së aftësisë profesionale të drejtuesit të mjetit.
3. Nëse i njëjti drejtues mjeti konstatohet duke drejtuar një mjet për të cilin është vendosur pezullimi i lejedrejtimit ose i certifikatës së aftësisë profesionale, gjatë kohës që është vendosur pezullimi, ai ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga njëqind mijë lekë deri në dyqind mijë lekë dhe bëhet pezullimi i dokumentit të drejtimit të konstatuar në të njëjtën periudhë pezullimi të evidentuar”.

### **Neni 12**

Në nenin 130, në fund të pikës 5, shtohen fjalët “si dhe zbatohet masa administrative plotësuese e konfiskimit të mjetit”.

### **Neni 13**

Neni 137 shtohet dhe ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

1. “Personeli që është i pajisur me lejedrejtimi dhe kryen shërbimin e policisë rrugore, policisë së rendit, policisë ushtarake, policisë së burgjeve dhe policisë bashkiake të treguar në nenin 12, pika 1, për drejtimin e mjeteve të regjistruara vetëm për një përdorim të tillë, duhet të pajiset me një lejedrejtimi të veçantë shërbimi, që tregon emrin dhe adresën e mbajtësit, të gjitha të dhënat e nevojshme për identifikimin e tij, kualifikimin dhe institucionin, agjencinë apo strukturën nga e cila varet.
2. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike merr masa në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me mjetet e saj, për kontrollin teknik, regjistrimin dhe lëshimin e dokumenteve të qarkullimit e të targave të njohjes, si dhe të certifikatave të aftësisë profesionale të veçanta (leje drejtimi shërbimi).

3. Mjetet e ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, kur kalojnë kufijtë e përcaktuar në nenet 61 dhe 62 të këtij Kodi, për të qarkulluar në rrugë duhet të pajisen me një autorizim të veçantë, që lëshohet nga Drejtoria Qendrore e Policisë Rrugore.
4. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike merr masa në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me personelin në drejtimin e mjeteve:
  - a. Për trajnimin dhe verifikimin e aftësive të nevojshme për drejtimin e mjeteve, provimin e aftësisë për lëshimin e certifikatës profesionale të veçantë të shërbimit, që vlen vetëm për drejtuesit e mjeteve që i përkasin ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike apo institucioneve të saj të varësisë.
  - b. Për lëshimin e certifikatës profesionale të veçantë për drejtimin e mjeteve të shërbimit, organizohen kurse teorike e praktike me afate të caktuara. Kohëzgjatja e kurseve dhe mënyra e marrjes në prova, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
  - c. Certifikatat profesionale të veçanta për drejtimin e mjeteve të shërbimit, lëshohen mbi bazën e lejedrejttimeve ekzistuese që ka çdo drejtues mjeti, të lëshuara nga ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse të transportit.
5. Mjetet e loguara nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, regjistrohen nga ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse, pas verifikimit paraprak të kërkesave të përcaktuara në aktet në fuqi.
6. Kushdo drejtues mjeti që drejton një mjet të sistemit të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, i pajisur me lejedrejtimi përkatëse, por i pa pajisur me certifikatën profesionale të veçantë, ndëshkohet me gjobë nga dy mijë e pesëqind lekë deri në dhjetë mijë lekë.

#### **Neni 14**

Në nenin 140, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“6. Për përcaktimin e pajtueshmërisë me kufijtë e shpejtësisë, rezultatet e pajisjeve të aprovuara konsiderohen burime prove, gjithashtu për llogaritjen e shpejtësisë mesatare të qarkullimit në seksione të caktuara. Konsiderohen gjithashtu prova regjistrimet e tahogرافit. Stacionet/pikat e kontrollit në rrjetin rrugor për identifikimin e tejkallimit të shpejtësisë, duhet të jenë më parë të shënuara dhe qartësisht të dukshme, duke përdorur shenjat/tabelat vertikale dhe horizontale, ose nëpërmjet pajisjeve sinjalizuese të ndritshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për zbatimin e këtij Kodi dhe udhëzimit të ministrave përgjegjës për transportin dhe rendin publik.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Kushdo tejkallon kufijtë maksimalë të shpejtësisë me jo më shumë se 10 km/orë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga një mijë deri në tre mijë lekë”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Kushdo që tejkalon kufijtë maksimalë të shpejtësisë me më shumë se 10 km/orë dhe jo më shumë se 30 km/orë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga dy mijë deri në katër mijë lekë”.

4. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Kushdo tejkalon kufijtë maksimalë të shpejtësisë me më shumë se 30 km/orë por jo më shumë se 50 km/orë jashtë qendrave të banuara dhe më shumë se 20 km/orë, por jo më shumë se 40 km/orë në qendrat e banuara, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë. Si pasojë e kësaj shkelje, aplikohet edhe masa administrative shtesë e pezullimit të lejes së drejtimit nga një deri në tre muaj, si dhe i heqjes së tre pikëve.

5. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 si më poshtë:

9/1. Kushdo tejkalon kufijtë e shpejtësisë maksimale për më shumë se 50 km/orë jashtë qendrave të banuara dhe më shumë se 40 km/orë në qendrat e banuara, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga njëqind mijë lekë deri në dyqind mijë lekë. Si pasojë e kësaj shkelje, aplikohet masa administrative shtesë e pezullimit të lejes së drejtimit nga tre deri në gjashtë muaj dhe për këtë shkelje hiqen 6 pikë”.

6. Pika 10 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“10. Kushdo që shkel dispozitat e përmendura në paragrafin 4, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga 20 mijë deri në 40 mijë lekë”.

7. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Nëse shkeljet e përmendura në paragrafët 7, 8, 9 dhe 9/1 janë kryer gjatë drejtimit të automjeteve të treguar në paragrafin 3, shkronjat “b”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “l”, gjobat dhe masat plotësuese dyfishohen. Tejkalimi i shpejtësisë përtej kufirit në të cilën është kalibruar kufiri i shpejtësisë, i përmendur në nenin 179, nënkupton aplikimin e masave administrative të parashikuara në paragrafët 2/1 dhe 3 të të njëjtit nen, në automjetet që kërkohen për të montuar këtë pajisje”.

8. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. Kur zotëruesi i lejedrejtimit, në një periudhë dy vjeçare, ka kryer shkelje të mëtejshme të paragrafit 9 dhe 9/1, lejedrejtimi ose i certifikata e aftësisë profesionale pezullohen nga tetë deri në tetëmbëdhjetë muaj.

9. Pas pikës 12, shtohet pika 13 me këtë përmbajtje:

“13. Zotëruesi i lejedrejtimit shqiptar, i cili në tri vitet e para të marrjes së lejedrejtimit tejkalon limitet e shpejtësisë së mjeteve të përcaktuara në këtë nen, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, në dyfishin e vlerës së parashikuar në paragrafët e këtij neni. Shkelja e mësipërme përveç masës administrative me gjobë ndëshkohet edhe me masën plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit për dyfishin e afatit të parashikuar në këtë nen të këtij Kodi”.

10. Pas pikës 13 shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:

“14. Subjektet e përmendura në paragrafin 12-2 shpërndajnë shumat që rrjedhin nga caktimi i aksioneve të të ardhurave nga sanksionet administrative financiare, të përmendura në të njëjtin paragraf, për zbatimin e masave të mirëmbajtjes dhe sigurisë për infrastrukturën rrugore, përfshirë sistemet e sinjalizimit rrugor dhe pengesat, si dhe forcimin e kontrollit dhe verifikimin e shkeljeve që lidhen me trafikun rrugor, përfshirë shpenzimet e personelit, në përputhje me legjislacionin aktual në lidhje me kontrollin e shpenzimeve të punësimit publik dhe marrëveshjet e brendshme, sikundër specifikohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

14. Subjekti i autorizuar lokal transferon online dhe zyrtarisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Brendshme, deri më 31 maj të çdo viti, një raport financiar të detajuar, i cili tregon duke iu referuar një viti më parë, shumën totale të të ardhurave që i përkasin atij në bazë të paragrafit 12-2 të këtij neni, si rezultat i raportit të miratuar në të njëjtin vit, dhe ndërhyrjeve të kryera në këto burime, me specifikimin e kostove të bëra për secilën ndërhyrje.

Përqindja e të ardhurave për shkak të paragrafit 12 zvogëlohet me 90 % në vit, ndaj subjektit që nuk transmeton raportin e përmendur në periudhën e mëparshme, ose që përdor të ardhurat e përmendura në periudhën e parë në një mënyrë të ndryshme nga ajo që parashikuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave dhe nga paragrafi 12-3 i këtij neni, për çdo vit për të cilin haset një nga paragrafët e lartpërmendur.

## **Neni 15**

Në nenin 143, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 5, të nenit 143, pas fjalës “ndalojnë” shtohet “me qëndrim të plotë”.
2. Në pikë 10, fjalët “nga një mijë deri në tre mijë lekë” zëvendësohen me fjalët “nga pesë mijë deri në tetë mijë lekë”.
3. Në fund të pikës 11, shtohen fjalët “dhe i hiqen 3 pikë”.
4. Pas pikës 11, shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. Në rast të verifikimit të një aksidenti me dëme materiale ku është identifikuar si shkelje mosrespektimi i përparësisë, për këtë shkelje drejtuesi i mjetit fajtor ndëshkohet përveç masës administrative me gjobë sipas pikës 10, edhe me heqjen e 3 pikëve.

## **Neni 16**

Në nenin 146 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 16 ndryshon si vijon:

“16. Kushdo që nuk zbaton ndalimet e parakalimit, sipas pikave 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga pesë mijë deri në dhjetë mijë lekë. Kur nuk zbatohen ndalimet e parakalimit, sipas pikës 14 të këtij neni, masa administrative është me gjobë, nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë. Kushdo që konstatohet me këtë shkelje dy herë brenda të njëjtit vit, ndëshkohet me dyfishin e masës së parashikuar në paragrafin 16 dhe i pezullohet leja e drejtimit për një muaj.”

2. Pas pikës 16, shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

“17. Në rast të verifikimit të një aksidenti me dëme materiale ku është identifikuar si shkelje parakalimi i gabuar, drejtuesi i mjetit fajtor për këtë shkelje ndëshkohet përveç masës administrative me gjobë sipas pikës 16, edhe me heqjen e 3 pikëve”.

### **Neni 17**

Në nenin 155 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 5, në fund shtohen fjalët “përrjashtim bëjnë mjetet autoveturë gjatësia e të cilave nuk e kalon kuadratin e sinjalizuar për parkim të entit pronar të rrugëve”.
2. Pika 8 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“8. Kujtdo që shkel dispozitat e këtij neni, 3 herë brenda një viti si dhe kushdo që parkon në mënyrë abuzive në vendet e përcaktuara në hapësirat e rezervuara për invalidët, ose parkon në trotuar, përveç masës administrative me gjobë i hiqen edhe 2 pikë nga leja e drejtimit”.

### **Neni 18**

Në nenin 169, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikë 2, fjalët “nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë” zëvendësohen me fjalët “nga njëmijë deri në tre mijë lekë”.
2. Pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen si vijon:

“5. Drejtuesi i motomjeteve është i detyruar të bëhet i dallueshëm në trafik gjysmë ore pas perëndimit të diellit deri gjysmë ore para lindjes së diellit, duke mbajtur një jelek fosforeshent, karakteristikat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit për transportin. Kushdo që nuk zbaton këtë detyrim ndëshkohet më masë administrative me gjobë, nga një mijë deri tre mijë lekë”.



## Neni 19

Në nenin 170, pika 8 ndryshon me këtë përmbajtje:

“8. Kushdo nuk përdor rripat e sigurisë dhe sistemet e fiksimit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë. Drejtuesi i mjetit ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga një mijë deri në tremijë lekë, nëse konstatohet se në mjetin që ai drejton ka pasagjerë që nuk kanë vendosur rripin e sigurimit.

## Neni 20

Në nenin 171 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2. Është e ndaluar që drejtuesi i mjetit të përdorë gjatë lëvizjes mjete teknologjike të komunikimit dhe ndërveprimit, si aparatura radiotelefoni apo celulare, kufje zanore, me përjashtim të drejtuesve të mjeteve të Forcave të Armatosura dhe të policisë. Përdorimi i pajisjeve pa kufje ose kufje lejohet për sa kohë që drejtuesi i mjetit ka aftësi të përshtatshme dëgjimi në të dy veshët, të cilat nuk kërkojnë përdorimin e duarve për funksionimin e tyre”.

2. Në pikë 3, fjalët “nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë” zëvendësohen me fjalët “nga pesëmijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë”.

3. Pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen si më poshtë:

“4. Në raste të përsëritjes së shkeljes së mësipërme 3 herë brenda të njëjtit vit, drejtuesit të mjetit i pezullohet leja e drejtimit 3 muaj dhe i hiqen 10 pikë”.

## Neni 21

Në nenin 173, në shkronjën “a” të pikës 1, fjala “150 cc” zëvendësohet me “949 cc”.

## Neni 22

Neni 184, ndryshohet si më poshtë:

1. Ndalohet drejtimi i mjetit pas përdorimit të pijeve alkoolike.

2. Kushdo që drejton mjetin nën ndikimin e alkoolit ndëshkohet me masë administrative:

- a. me masë administrative, gjobë në vlerën prej pesëmijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkoolike deri në 0,3 gram për litër (g/l); përjashtim bëjnë drejtuesit e mjeteve që kanë më pak se tre vjet vjetërsi lejedrejtimi, si dhe drejtuesit e mjeteve me peshëmbajtje mbi 3,5 ton, të mjeteve taksit dhe të shërbimit të transportit publik, për të cilët përveç masës së parashikuar me gjobë pezullohet certifikata e aftësisë

- profesionale nga tre muaj deri ne 6 muaj.
- b. me masën administrative gjobë nga dhjetëmijë deri ne njëzet mijë lekë, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkoolike më të lartë se 0.3 gram për litër dhe jo më të lartë se 0.5 gram për litër (g/l). Konstatimi i shkeljes shoqërohet nga masën administrative shtesë të pezullimit të lejes së drejtimit nga tre deri në gjashtë muaj;
  - c. me masë administrative me gjobë nga njëzet lekë deri në katërqind mijë lekë dhe me pezullim të lejedrejtimit nga 12 muaj deri në 24 muaj, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli më të lartë se 0.8 dhe deri në 1.5 gram për litër;
  - d. në çdo rast, masën administrative me gjobë dhe atë plotësuese të pezullimit të lejes së drejtimit, për rastet e konstatimit të drejtuesit të mjetit në gjendje të dehur me përdorim alkooli në vlerën mbi 0,5 g/litër i vendosur nga organi i Policisë Rrugore, i dërgohet zyrtarisht organit hetimor qe ka filluar procedimin penal, në zbatim të dispozitave të Kodit Penal – neni 291 “Drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt”.
3. Nëse drejtuesi i mjetit në gjendje të dehur shkakton një aksident rrugor me pasojë dëmi material, përveç masave administrative sipas përqindjes së alkoolit të evidentuar, bëhet edhe ndalimi administrativ i automjetit për dy muaj, përveç rasteve kur automjeti i përket një personi që nuk ka lidhje me veprën penale.
  4. Nëse për drejtuesin e mjetit që shkakton një aksident rrugor, është evidentuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli më të lartë se 1.5 gram për litër (g/l), duke respektuar dhe plotësuar dispozitat përkatëse në këtë nen, lejedrejtimi hiqet duke zbritur të gjithë pikët që drejtuesi i mjetit ka në dispozicion në lejedrejtimin e tij.
  5. Nëse drejtuesi mjetit konstatohet në gjendje të dehur dhe automjeti nuk mund të drejtohet nga një person tjetër i përshtatshëm, ai mund të transportohet në vendin e treguar nga pala e interesuar, ose në garazhin më të afërt dhe të lihet t'i dorëzohet pronarit ose menaxherit të tij me garancitë normale të kujdestarisë. Kostot e rimëkëmbjes dhe transportit përballohen plotësisht nga kundërvajtësi.
  6. Masa administrative e parashikuar, rritet nga një e treta deri në një të dytën kur shkelja është kryer pas orës 22:00 dhe para orës 07:00 të mëngjesit.
  7. Për të evidentuar elementë të dobishëm për të justifikuar detyrimin për t'iu nënshtruar hetimeve të përmendura në paragrafin 4, organet e policisë rrugore të përmendura në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2, sipas direktivave të dhëna nga Ministria e Brendshme, në përputhje me kushtet e privatësisë personale dhe pa paragjykuar integritetin fizik, drejtuesit e mjeteve janë të detyruar t'i nënshtrohen testeve jo cilësore ose testeve të cilësisë, përmes pajisjeve portative të homologuara të miratuara me akte nënligjore.
  8. Kur kontrollet cilësore të përmendura në paragrafin 3 kanë dhënë një rezultat pozitiv, në çdo rast aksidenti ose kur ka ndonjë arsye tjetër të besohet se drejtuesi i automjetit është në gjendje të ndryshimit psikofizik që rrjedh nga ndikimi i alkoolit, organet e policisë rrugore të përmendura në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2, marrin masa gjithashtu duke i shoqëruar drejtuesit e mjeteve në zyrën ose komandën më të afërt, ku kanë të drejtë të kryejnë vlerësimin me mjete dhe procedura të përcaktuara me Rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor.
  9. Për drejtuesit e mjeteve të përfshirë në aksidente rrugore dhe që i nënshtrohen trajtimit mjekësor, vlerësimi i nivelit të alkoolit në gjak kryhet me kërkesë të organeve të policisë

rrugore të përmendur në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2, nga subjektet shëndetësore ose ata të akredituar për këto qëllime. Strukturat shëndetësore lëshojnë certifikimin relativ pranë organeve të policisë rrugore për rastet e kërkuara, duke siguruar përputhjen me konfidencialitetin e të dhënave, bazuar në dispozitat aktuale të ligjit. Një kopje e analizave i dërgohet organit hetimor që ka filluar hetimet, për çdo masë përkatëse të mëtejshme.

10. Nëse vlerësimi i përmendur në paragrafët 4 ose 5, tregon një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli më të lartë se 0,5 gram për litër (g/l), pala e interesuar konsiderohet se është në gjendje të dehur, me qëllim të aplikimit të masave e përmendura në këtë nen.
11. Me urdhrin me të cilin kryhet heqja e lejedrejtimit dhe humbja e totalit të pikëve në dispozicion sipas përcaktimeve të paragrafit 2-1, organi i policisë rrugore urdhëron që drejtuesi i mjetit t'i nënshtrohet një kontrolli mjekësor, sipas parashikimeve të pikës 8 të këtij neni. Nëse fakti është kryer nga një subjekt tashmë i dënuar në dy vitet e mëparshme për të njëjtin kundërvajtje, masën administrative plotësuese të heqjes së lejedrejtimit, është i detyrueshëm të bëhet gjithmonë.
12. Me vendimin me të cilin është rregulluar pezullimi i lejedrejtimit në bazë të pikës 2 dhe 2-2, organi i policisë rrugore urdhëron që drejtuesi i mjetit t'i nënshtrohet një kontrolli mjekësor, në bazë të nenit 119, paragrafi 4, i cili duhet të bëhet në afatin prej gjashtëdhjetë ditësh. Nëse drejtuesi i mjetit nuk paraqet brenda afatit të caktuar, organi i Policisë Rrugore mund të urdhërojë, si masë paraprake, pezullimin e lejes së drejtimit deri në përfundimin e ekzaminimit mjekësor.
13. Nëse vlerësimi i përmendur në pikat 4 dhe 5, tregon një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli më të lartë se 1.5 gram për litër, pa paragjykuar zbatimin e masave të përmendura në këtë nen, organi policor, si masë paraprake urdhëron pezullimin e licencës, deri në përfundimin e ekzaminimit mjekësor.
14. Duke konsideruar bashkëshoqërimin e veprës penale me shkeljen administrative, parashikuar në dispozitat e këtij kodi, në çdo rast të evidentimit të drejtuesve të mjeteve në gjendje të dehur, organi i policisë rrugore procedon duke zbatuar dispozitat e mësipërme.
15. Në zbatim të afateve të kodit rrugor vendimet e policisë, masat dhe pezullimi i lejedrejtimit, i dërgohen organit procedues të prokurorisë.

### **Neni 23**

Neni 187 ndryshohet si më poshtë:

### **Neni 187**

#### **“Mënyra e veprimit në rast aksidenti**

1. Përdoruesi i rrugës, në rast aksidenti, në çdo rast që i atribuohet sjelljes së tij, ka detyrimin të ndalojë dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme për ata që kanë pësuar dëme për personin.
2. Personat e përfshirë në një aksident, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur sigurinë e trafikut dhe në përputhje me këtë kërkesë, të ndërmarrin hapa për të

siguruar që gjendja e vendeve të mos ndryshohet dhe gjurmët e dobishme për konstatimin e përgjegjësive të shpërndahen.

3. Nëse dëmtimi i pronës lind vetëm nga aksidenti, drejtuesit e mjeteve dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë gjithashtu, kur është e mundur, të shmangin pengesat në trafik, në përputhje me parashikimet e këtij kodi. Agjentët në shërbimin e policisë së trafikut, në raste të tilla, urdhërojnë heqjen e menjëhershme të çdo pengese për trafik, përveç ekzekutimit me urgjencë absolute, të çdo gjetjeje të nevojshme për të konstatuar modalitetet e aksidentit.
4. Në çdo rast, drejtuesit e mjeteve gjithashtu, duhet të sigurojnë detajet e tyre personale, si dhe informacione të tjera të dobishme, gjithashtu për qëllime kompensimi, për personat e dëmtuar ose nëse nuk janë të pranishëm, t'u komunikojnë atyre në mënyrat e mundshme elementet e mësipërme.
5. Aty ku si pasojë e ngjarjes rrugore, janë shkaktuar vetëm dëme material, drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë në aksident, duhet gjithashtu, të shmangin pengimin e qarkullimit, aty ku është e mundur, sipas dispozitave të nenit 159 dhe të njoftojnë shoqërinë/shoqëritë përkatëse të sigurimit. Palët hartojnë procesverbalin përkatës të ngjarjes (raportin miqësor për ngjarjen) dhe ja paraqesin për veprime të mëtejshme shoqërisë/shoqërive të sigurimit.
6. Aty ky si pasojë e ngjarjes rrugore janë shkaktuar vetëm dëme materiale në mjetin/mjetet motorike dhe palët e përfshira nuk bien dakord për një raport “miqësor” mbi ngjarjen, drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i përfshirë në aksident, duhet të njoftojë organet e Policisë së Shtetit dhe shoqërinë/shoqëritë përkatëse të sigurimit për kryerjen e veprimeve dhe administrimin e dokumentuar të ngjarjes rrugore.
7. Aty ku si pasojë e ngjarjes rrugore janë shkaktuar edhe dëmtime të rrugës dhe elementëve përbërës të saj, si dhe dëme të tjera pasurore (përveç dëmeve në mjetin/mjetet rrugore), drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë në aksident, në çdo rast njoftojnë organet e Policisë së Shtetit dhe shoqërinë/shoqëritë përkatëse të sigurimit, për kryerjen e veprimeve dhe administrimin e dokumentuar të ngjarjes rrugore.
8. Kushdo që në kushtet e përmendura në pikën 1, nuk respekton detyrimin për të ndaluar në rast aksidenti, me dëmtim vetëm të pasurisë, i nënshtrohet masës administrative të pagimit të një shume nga 10 mijë deri në 15 mijë lekë.

#### **Neni 24**

Në nenin 189, pika 2 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2. Në rrugë të pa pajisura me vendkalime këmbësorësh, drejtuesit e mjeteve duhet t'i lejojnë këmbësorit që ka filluar kapërcimin e karrexhatës, të arrijë i sigurt në anën tjetër, edhe në rastet kur pa filluar kapërcimin duket sikur po e kapërcen apo ka ndërmend ta kapërcejë dhe duhet të shmangin situata të rrezikshme që mund sjelle aksidente”.

#### **Neni 25**

Në nenin 191, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kushdo që qarkullon pa qenë i siguruar, ndëshkohet me masë administrative me

gjobë, sipas dispozitave të ligjit organik të posaçëm”.

#### **Neni 26**

Në nenin 192, shtohet paragraf i ri me përmbajtjen si më poshtë:

“Për një kategori shkeljesh rrugore, për të cilat agjenti verifikues vendos të këshillojë kundërvajtësin, këshillimi duhet të administrohet në sistemet e policisë. Drejtuesi i mjetit i këshilluar dhe evidentuar në sistem, nëse konstatohet me të njëjtën shkelje brenda një viti, vendoset masa maksimale e parashikuar nga dispozita e shkelur”.

#### **Neni 27**

Në nenin 199, në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Njoftimi i shkeljeve dhe i vendimeve që merren nga organet e përcaktuara me normat e këtij kodi, i dërgohen kundërvajtësve edhe në postë (adresat) elektronike të tyre të certifikuara”.

#### **Neni 28**

Neni 201 ndryshon si më poshtë:

“Neni 201

Shqyrtimi i kundërvajtjes tek organi administrativ

Kundërvajtjet sipas këtij kodi, shqyrtohen sipas rastit vetëm në bazë të ankesës së shtetasve kundërvajtës, nga organi administrativ shtetëror në territorin e të cilit është efektiv agjenti verifikues, ose në organin administrativ ku ka adresën e banimit kundërvajtësi, organe të cilat marrin vendimin përkatës”.

#### **Neni 29**

Në nenin 212, pika 6 ndryshohet si vijon:

“Kushdo që gjatë periudhës kur është tërhequr dokumenti qarkullon në mënyrë abuzive me të njëjtin mjet, të cilit i referohet tërheqja e dokumentit, dënohet me gjobë nga dhjetëmijë deri në dyzet mijë lekë, zbatohet edhe masa administrative plotësuese e heqjes së lejedrejtimit”.

#### **Neni 30**

Në nenin 215 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4, pas fjalës “kualifikimit” shtohen fjalët “pas kalimit të një kursi formimi”.

2. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 ose 5 me këtë përmbajtje:

“4/1 ose 5. Kushdo që qarkullon pasi është masa administrative e heqjes së lejedrejtimit, dënohet sipas dispozitave të nenit 291 të Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, i ndryshuar”.

### **Neni 31**

Në nenin 217, shtohet paragraf i ri me përmbajtjen si më poshtë:

“Organi administrativ i policisë, për shkelje që parashikohen edhe si kundërvajtje administrative, plotëson procedurat e kërkuara nga Kodi Rrugor dhe për vendimet që merr, njofton brenda afateve të këtij kodi organin procedues të Prokurorisë dhe të Gjykatës sipas rastit. Kjo e fundit pasi ka administruar në fashikull edhe procedimin administrativ në vendimin përfundimtar, evidenton sa më sipër”.

### **Neni 32**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOS RUÇI**